



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE MITROVICË

Numri i lëndës: 2023:000835

Datë: 26.01.2023

Numri i dokumentit: 03905905

P.nr.09/2023

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË - Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Penal gjyqtarja e vetme gjykuese Benita Berisha, me procesmbajtësen – praktikanten Diellza Bojku, në çështjen penale ndaj të pandehurit Sh. P. nga M. për shkak të veprës penale: Vjedhja e pyllit nga neni 349 par.1 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (tutje: KPRK), duke vendosur sipas Aktakuzës së Prokurorisë në Mitrovicë - Departamenti i Përgjithshëm PP.nr.II.nr.2352/2022, të datës 29.12.2022 dhe kërkesës për shqiptimin e urdhrit ndëshkimor, pa mbajtjen e shqyrtimit gjyqësor, jashtë seancës me datë 26.01.2023, mori këtë:

A K T G J Y K I M

PRANOHET Kërkesa e Prokurorisë Themelore në Mitrovicë – Departamenti i Përgjithshëm PP.nr.II.nr.2352/2022, të datës 29.12.2022 dhe kjo gjykatë konform dispozitës të nenit 495 të KPPK-së, jep këtë:

URDHËR NDËSHKIMOR

I pandehuri:

Sh. P., nga i ati I., e ëma S., i lindur më me vendbanim në fshatin M. të Komunës së M., me nr. personal i gjendjes së dobët ekonomike, i papunë, i pamartuar, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

ËSHTË FAJTOR

Sepse:

Me datë 21.10.2022, rreth orës 12:59, në terrenin e fshatit M., në vendin malor të quajtur “T e A.” të komunës së M., i pandehur Sh. P. me qëllim vjedhje, në pyllin e pronësisë shoqërore administruar nga A.P.K zyra në Mitrovicë, ka prerë 241 copë dru, të llojit Bungu, me dimensione diametri 8 cm, lartësia 9 m, me vëllim të përgjithshëm prerë 2.41 m³, me cka ka shkaktuar dëm në vlerë prej 368.63 € kështu duke e dëmtuar A.P.K-në zyra Mitrovicë.

Me këtë ka kryer veprën penale: Vjedhja e Pyllit nga neni 349 par. 1 të KPRK-së.

Andaj, gjykata në bazë të nenit 1, 4, 7, 17, 21, 38, 39, 40, 43, e 69 e 349 par.1 të KPRK-së, si dhe nenit 365, 450, 453, 463, 493 e 495 të KPPK-së, të pandehurit i:

S H Q I P T O N

- I. Dënim me gjobë në shumë prej 200€ (dyqind euro), të cilin dënim është i obliguar që ta paguaj në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimit. Nëse i pandehuri nuk e paguan gjobën në afatin e caktuar, gjykata do të veprojë në bazë të nenit 43 par.3 të KPRK-së, ashtu që dënimin me gjobë do të ia zëvendësoj me dënim me burgim, duke i llogaritur për çdo 20 € (njëzet) euro gjobë me një 1(ditë)burg.
- II. Obligohet i pandehuri që në emër të shpenzimeve procedurale dhe atë në emër të paushallit gjyqësorë të paguaj shumën prej 20€, ndërsa në emër të taksës për kompensimin e viktimave të krimit shumën prej 30€, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përbarimit me detyrim.
- III. Pala e dëmtuar-Autoriteti Pyjor Komunal në Mitrovicë, për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet në kontest të rregullt juridiko-civil.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Mitrovicë – Departamenti i Përgjithshëm, ka ngritur aktakuzën PP.nr.II.nr.2352/2022, të datës 29.12.2022, kundër të pandehurit Sh. P. për shkak të veprës penale: Vjedhja e pyllit nga neni 349 par.1 të KPRK-së dhe njëherësh, nga gjykata ka kërkuar dhënien e urdhrin ndëshkimor- Dënim me gjobë, me arsyetimin se ka prova të besueshme nga kallëzimi penal dhe provat e propozuara lidhur me arsyeshmërinë e aktakuzës së propozuar në drejtim të vërtetimit të fakteve se i pandehuri, vërtetë e ka kryer veprën penale për të cilën akuzohet.

Gjykata, me rastin e shqyrtimit paraprak të çështjes, gjeti se aktakuza dhe kërkesa janë të bazuara dhe se janë plotësuar kushtet nga neni 493 i KPPK-së, që të pranohet kërkesa për dhënien e urdhrin ndëshkimor dhe në përputhje me nenin 495 të KPPK-së të jepet aktgjykimi pa u mbajtur shqyrtimi gjyqësorë, si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, pasi që në shkresat e lëndës ka prova të mjaftueshme në bazë të të cilave vërtetohet se i pandehuri e ka kryer veprën penale e cila i vihet në barrë.

Gjykata, konsideron se provat e bashkangjitura në shkresat e lëndës dhe atë: Shënimet personale dhe dëmi i shkaktuar me nr.85/22 i datës 15.11.2022, Fletëparaqitja për dëmin e pyllit, fotoalbumi nga vendi i ngjarjes me gjithsej katër (4) fotografi dhe shkresat tjera të lëndës, janë prova të besueshme mbi bazën e të cilave vërtetohet se i pandehuri ka kryer veprën penale për të cilën është akuzuar.

Sipas KPRK-së, për veprën penale: Vjedhja e pyllit nga neni 349 par.1 të KPRK-së, është paraparë dënimi me gjobë ose me burgim deri në një (1) vit.

Gjykata në përputhje me nenin 69 të KPRK-së, me rastin e caktimit të lartësisë së dënimit me gjobë, vlerësojë të gjitha rrethanat në matjen e dënimit, ashtu që gjykata është e bindur se dënimi i shqiptuar është në proporcion me peshën e veprës penale, përgjegjësinë penale dhe shkallën e rrezikshmërisë shoqërore, duke vlerësuar se me një dënim të tillë do të arrihet qëllimi i dënimit, i cili parashihet me nenin 38 të KPRK-së, pasi që njëra nga qëllimet e dënimit është të parandalojë kryerësin nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe të bëjë rehabilitimin e tij, të parandalojë personat e tjerë nga kryerja e veprave penale, të shpreh gjykimin shoqëror për veprën penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit dhe se i pandehuri do të përmbahet nga prerja e pyjeve dhe veçanarisht të ketë kujdes të shtuar, që të mos i dëmtoj pyjet, në çfarëdo forme, në mënyrë që të mos rrezikohet pasuria materiale e askujt. Poashtu, ky dënim do të shërbejë si masë preventive që në të ardhmen i pandehuri të përmbahet nga çfarëdo veprimi me të cilin çënohet pasuria e të tjerëve.

Vendimi për kompensimin e shpenzimeve të procedurës penale, për paushallin gjyqësor, u bazua në nenin 450 par.2 pika 2.6 dhe 453 par, 1 të KPP-së. Ndërsa taksa për kompensimin viktimave të krimit, në kuptim të nenit 39 par. 3 të Ligjit nr. 05\L-036 për Kompensimin e Viktimave të Krimit.

Vendimi për udhëzimin e palës së dëmtuar në kontest të rregullt juridiko-civil për realizimin e kërkesës pasurore juridike është marrë në bazë të nenit 463 par. 2 lidhur me par.1 të KPPK-së.

Nga sa u tha më lart, e në bazë të neneve 365 e 495 të KPPK, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË
Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Penal
P.nr.09/2023, datë 26.01.2023

Diellza Bojku
Procesmbajtëse-praktikante

G j y q t a r j a:

Benita Berisha

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi i pandehuri dhe mbrojtësi i tij mund të paraqesin kundërshtim, në afat prej 8 (tetë) ditëve, nga dita e pranimit të të njëjtit. Kundërshtimi i parashtrohet kësaj Gjykate.